



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

RAPORT MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT 2023-2024  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....

METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....

PROGRESI NE ZBATIM DHE GJETJET E RAPORTIT.....

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....

## 1. Hyrje

Ky raport monitorimi synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) për periudhën 2023-2024. Plani është hartuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe ka për qëllim rritjen e integritetit institucional dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve publike.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator i Integritetit të Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme. Këto të dhëna janë raportuar nga koordinatorët e riskut sipas drejtorive të AZHBR-së mëposhtë:

Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve  
Drejtoria e Kontrollit  
Drejtoria e Financës  
Drejtoria e Autorizimit të Pagesave  
Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave  
Drejtoria e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut  
Drejtoria e Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit  
Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse  
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm  
Drejtoria e Parandalimit të Mashtrimit, Parregullsisë dhe Riskut  
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit

### Metodologjia e Monitorimit

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është kryer nëpërmjet:

- Vlerësimit të dokumentacionit dhe praktikave institucionale;
- Intervistave me stafin e institucionit;
- Analizës së riskut dhe masave të zbatuara;
- Raportimit të rregullt nga strukturat përgjegjëse për implementimin e masave.

Koordinatori i Integritetit ka kryer vlerësime çdo gjashtë muaj, duke analizuar përparimet dhe sfidat në zbatimin e Planit të Veprimit.

### Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit

Emri	Pozicioni
Hektor Muçaj	Koordinator/Kryetar, Drejtor i Drejtorisë së Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut

Znj. Antoneta Qemali	Koordinator Risku në Drejtorinë Juridike dhe të Shërbimeve Mbështetëse
Z. Genci Çomo	Koordinator Risku në Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve
Znj. Xhilda Mustafaraj	Koordinator Risku në Drejtorinë e Kontrollit
Znj. Sara Çausi	Koordinator Risku në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave
Znj. Lorena Kolaj	Koordinator Risku në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave
Znj. Enkereta Kora	Koordinator Risku, në Drejtorinë e Financës
Znj. Kostanca Hasmeta	Koordinator Risku në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit
Z. Roland Papajorgji	Koordinator Risku në Drejtorinë e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut
Znj. Majlinda Polisi	Koordinator Risku në Drejtorinë e Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit
Znj. Edlira Stavre	Koordinator Risku në Sektorin e Auditimit të Brendshëm

## 2. Progresi në Zbatimin e Planit të Integritetit

### Objektivat Strategjikë 2023-2024

Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për një menaxhim sa më efektiv të fondeve të BE-së dhe atyre të Qeverisë Shqipëtare në fushën e zhvillimit bujqësor dhe rural.

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies.

**OBJEKTIVI 1: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM PËR NJË MENAXHIM SA MË EFEKTIV TË FONDEVE TË BE-SË DHE ATYRE TË QEVERISË SHQIPTARE**

	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Masat e marra
1	Vonesa në marrjen e besimit për akreditimin e procedurave për masat e reja në kuadër të programit IPARD III.	Bashkëpunim efektiv me të gjitha strukturat e përfshira në proces.
2	Mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë i strukturave operacionale dhe drejtuese për finalizimin e procesit.	Bashkëpunim i ngushtë me ZKA dhe AM.
3	Mungesa e Stafit të nevojshëm për të siguruar ndarjen e detyrave midis IPARD dhe skemave kombëtare.	Rritja e numrit të stafit bazuar në analizën e ngarkesës së punës.
4	Risku i parregullsive, mashtrimeve të ndryshme.	Ndjekja Sistematike e flamujve të kuq dhe sinjaleve të parregullsive.
5	Mospërmbushja e afateve për paraqitjen e raporteve të kërkuara pranë strukturave të tjera si shkak i raportimit të vonesave nga drejtoritë e AZHBR-së tek Oficeri i Raportimit.	Komunikim i ngushtë me punonjësit përgjegjës të caktuar për raportimin e aktiviteteve në departamentet/drejtoritë e tyre. Mundësimi i aksesit të Zyrtarit të Raportimit në nxjerrjen e të dhënave të nevojshme direkt nga softwarët e ndryshëm të përdorur nga AZHBR me qëllim zbatimin e IPARD II, PROGRAMI KOMBËTAR PËR BUJQËSINË, ETJ.
6	Mos raportim të dhënash periodike të sakta të përpunuara nga drejtoritë e azhbr-së bë Sektorin e Raportimit.	Komunikim i ngushtë me punonjësit përgjegjës të caktuar për raportimin e aktiviteteve në departamentet/drejtoritë e tyre. Mundësimi i aksesit të Zyrtarit të Raportimit në nxjerrjen e të dhënave të nevojshme direkt nga softëaret e ndryshëm të përdorur nga AZHBR me qëllim zbatimin e IPARD II, programi kombëtar për bujqësinë, etj.

7	Risku i gjetjeve nga auditet e brendshme dhe të jashtme	Nxjerrja e mësimave nga raportet e gjetjeve të Auditit. Përmirësimi i kontrollit të brendshëm.
8	Risku i fondeve të paangazhuara.	Ndryshimi i afatit të finalizimit të investimit, monitorimi nga afër i përfituesve, shtyrja e tyre për të finalizuar dhe respektuar afatet. Argumentimi ndaj institucionit të BE-së për nevojën e miratimit të rregullit N+4.
9	Mospasqyrimi në kohë i ndryshimeve të legjislacionit në procedurat e punës së DPAP.	Komunikim i ngushtë me përgjegjës të emëruar për monitorimin e ndryshimeve të legjislacionit.

**OBJEKTIVI 2: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FORCIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE NË LIDHJE ME ETIKËN DHE INTEGRITETIN**

	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Masat e ndërmarra
1	Përshkrimet e punës dhe formularët e vlerësimit të punës nuk pasqyrojnë plotësisht detyrat shtesë	Rishikimi i përshkrimeve të punës. Përfshirja e detyrave shtesë në përshkrimet e punës.
2	Nubgesa e një programi të vazhdueshëm trajnimi për të gjithë stafin dhe sigurimi i zbatimit të plotë të tij.	Kërkesë për rritje të temave të trajnimit sipas pozicioneve të punës.
3	Mungesa e trajnimit për punonjësit e rinj të SAB.	Punonjësit e rinj do të trajnohen bazuar mbi planin e trajnimeve.
4	Mungesa e politikave të mbajtjes dhe motivimit të stafit në termat e pagave, bonuseve dhe kualifikimeve.	Rritja e pagave dhe ofrimi i kualifikimeve.
5	Mungesa e trajnimit për punonjësit e rinj të DPSA.	Transferimi i njohurive të trajnimit nga personeli më me përvojë tek të rinjtë. Kombinimi i punonjësve junior/senior në ekipe. Trajnim i planifikuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore në mënyrë që të punësojë ekspertët dhe të japë trajnime për stafin e DPSA-së.

### OBJEKTIVI 3: RITJA E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Masat e ndërmarra
1	Lajme të rreme, keqinformim	Krijimi i arkivave, historive të suksesit, takimeve dhe zhvillimi i mënyrave të reja të komunikimit.
2	Mungesa e komunikimit efektiv mes koordinatorit për të drejtën e informimit dhe drejtorive.	Bashkërendim i punës mes drejtorive dhe koordinatorit.

#### **3.1. Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për një menaxhim sa më efektiv të fondeve të BE-së dhe atyre të Qeverisë Shqipëtare në fushën e zhvillimit bujqësor dhe rural.**

Në vijim të raportimeve dhe statusit të përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm si një nga objektivat kryesore, për një menaxhim sa më efektiv të fondeve të BE dhe atyre të Qeverisë Shqiptare, më poshtë lutem gjeni pjesën nga DAB (Drejtorja e Auditimit të Brendshëm).

Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm – Vakant

Përgjegjës i Sektorit për Programin IPARD – Plotësuar

Specialist në sektorin e auditit për Programin IPARD – 3 vende nga të cilat 2 janë vakant dhe 1 është plotësuar.

Përgjegjës i Sektorit të Auditit për Skemat Kombëtare – Plotësuar

Specialist në Sektorin për Auditin e Skemave Kombëtare – 3 vende vakant.

Risku i gjetjeve nga auditimet e brendshme dhe të jashtme.

Drejtorja e auditimit të brendshëm si rezultat i mungesës së stafit të mjaftueshëm për kryerjen e funksioneve të saj është e ekzpozuar ndaj riskut për gjetje nga auditet e jashtme. Për të adresuar këtë çështje, AZHBR në bashkëpunim me DAB ka vënë në dijeni dhe e ka ngritur si shqetësim pranë zyrës së Ministrit të MBZHR, si dhe ka kërkuar ndërhyrjen për zgjidhjen e saj, pasi nga tentativat për rekrutim stafi të ri, nëpërmjet procedurat e rekrutimit dhe DAP nuk ka pasur kandidatë të mundshëm për të plotësuar vendet vakante. Ky shqetësim vazhdon të jetë risk për DAB sepse jemi dhe në prag të përgatitjes së paketës së akreditimit të Programit IPARD III.

Vlerësimi i progresit: 65% i zbatimit të masave

### **3.2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.**

#### Gjendja aktuale:

Struktura dhe organika në fuqi e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është miratuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 93 datë 12.6.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", nga e cilat janë miratuar në total 253 pozicione pune. AZHBR, në dhjetor të vitit 2024 ka patur në total 34 pozicione vakante, të cilat do të vijohen të plotësohen gjatë vitit 2025, nga njësia përgjegjëse DAP.

#### Përmirësime:

Të gjitha pozicionet vakante janë shpallur në faqen e web të DAP të cilat janë në proces rekrutimi. Është rritur numri i punonjësve të cilët kanë ndjekur tema trajnimi nga ASPA, ekspertë të huaj apo nga punonjësit më të vjetër të Agjencisë për punonjësit e rinj.

Nëpërmjet Urdhërit të Kryeministrit nr. 93, datë 12.6.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", u shtuan pozicione pune në AZHBR nga 239 në 253 me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe proceseve.

#### Sfida:

Nevoja për plotësimin e vendeve të lira dhe forcimi i kapaciteteve teknike të stafit.

Vlerësimi i progresit: 70% i zbatimit të masave

### **3.3 Rritja e transparencës dhe llogaridhënies.**

#### Gjendja aktuale:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në veprimtarinë e saj. Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve institucionale dhe rritjes së transparencës, AZHBR ka organizuar trajnime për stafin e saj, duke përfshirë përgatitjen dhe avancimin e auditimit të brendshëm në sistemet IT. Këto trajnime synojnë të sigurojnë një menaxhim më efikas dhe transparent të proceseve të brendshme.

Për më tepër, AZHBR ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me agjenci homologe, siç është ajo me Agjencinë Homologe Kroate (PAAFRD), për të shkëmbyer përvoja dhe praktika të mira në fushën e zhvillimit bujqësor dhe rural. Këto iniciativa tregojnë angazhimin e AZHBR-së për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien në funksionimin e saj, duke ndjekur standardet më të mira ndërkombëtare.

Gjithashtu, AZHBR ka publikuar Programin e Transparencës në faqen e saj zyrtare, ku përfshihen legjislacioni për të drejtën e informimit dhe aktet ligjore e nënligjore mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen



e sinjalizuesve. Ky program synon të sigurojë që informacionet mbi vendimmarrjen të jenë të qasshme për publikun, duke forcuar kështu llogaridhënien e institucionit ndaj qytetarëve.

Në përputhje me këto përpjekje, AZHBR ka krijuar kanale komunikimi për qytetarët, duke ofruar mundësinë e raportimit të parregullsive në adresat e dedikuara të postës elektronike. Kjo tregon një angazhim të qartë për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar një kulturë të transparencës dhe llogaridhënies në institucion.

Në përgjithësi, AZHBR po ndërmerr hapa konkretë për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, duke përfshirë trajnime të stafit, bashkëpunime ndërkombëtare dhe publikimin e informacioneve të rëndësishme për publikun. Këto masa synojnë të forcojnë besimin e qytetarëve dhe të përmirësojnë efektivitetin e shërbimeve të ofruara nga agjencia.

#### Përmirësime:

Janë zhvilluar metoda më të specializuara për

Vlerësimi i progresit: 90% i zbatimit të masave.

### **3. Përfundime dhe Rekomandime**

#### **4.1. Përfundime**

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit. Viti 2024, është viti i parë i zbatimit të këtij plani integriteti në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, dhe ka vijuar puna për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë plan brenda afateve kohore të përcaktuara.

Një strukturë e re organizative e Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural do të fillojë të zbatohet në vitin 2025.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën Janar-Dhjetor 2024, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezultojnë se:

- Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit.
- Drejtoritë dhe Sektorët e Agjencisë kanë realizuar një pjesë të mirë të objektivave.
- Për shkak të miratimit të një strukture dhe organike të re të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në zbatim të urdhrin të Kryeministrit Nr. 93, datë 12.06.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", fushat e përgjegjësisë ndoshta mund të ndryshojnë për objektivat specifike të Planit të Integritetit edhe pse shumica e objektivave është e realizuar.
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit <https://agjenciapërzvillimbujqësordherural.gov.al/>.

Koordinatori i Integritetit: HEKTOR MUÇAJ